



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 262 Prot

Tiranë, më 25.07 2014

VENDIM Nr. 333, dt. 15.07.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", (i ndryshuar), Neni 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 15.07.2014, mbasi shqyrtoi konceptin e gërmimit arkeologjik të paraqitur nga individi i licencuar nga KKA në fushën e arkeologjisë Prof. Skënder Ali "Për gërmimin e shpëtimit të një tume të dëmtuar nga thesar kërkues pranë fshatit Kabash në Rrethin e Kolonjës" – sipas kërkesës të Bashkisë Ersekë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitur nga individi i licencuar nga KKA në fushën e arkeologjisë Prof. Skënder Ali "Për gërmimin e shpëtimit të një tume të dëmtuar nga thesar kërkues pranë fshatit Kabash në Rrethin e Kolonjës" – sipas kërkesës të Bashkisë Ersekë.
- II. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit do të kryhet gjatë muajit shtator 2014, me drejtues projekti Prof. Skënder Ali.
- III. Gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit të realizohet mbikëqyrja arkeologjike periodike nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, sipas kontratës trepalëshe.
- IV. Pas përfundimit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit, Bashkia Ersekë, të marrë masa për konservimin, regjistrimin dhe ekspozimin e gjetjeve arkeologjike.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO